




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Emri i Biznesit: Lulzim As. Gashi B.I.
Numri Unik Identifikues: 810767030
Emri Tregtar: D.T.SH. "Smart Services"
Pronar: Lulzim GASHI
Operator i Shpërndarjes: IPTV SHQIP
Platforma: OTT
Adresa: Rr/Adem Jashari p.n., Pejë



VENDIM

për ndërprerjen dhe shpalljen e pavlefshme të licencës së Operatorit të Shpërndarjes IPTV SHQIP, me seli në Prishtinë

Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. IPTV SHQIP është operatorë i shpërndarjes i licencuar nga Komisioni i Pavarur për Media (KPM), për shpërndarjen e shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale përmes platformës Satelitore, në pajtim me Rregulloren KPM-2020/01, me seli në Pejë. KPM, me datën 4 nëntor 2019, ka marr vendim për dhënien e licencës për Operatorin e Shpërndarjes IPTV SHQIP.
3. IPTV SHQIP, me datën 16 dhjetor 2021, përmes një shkrese të dorëzuar në Zyrën Ekzekutive të KPM-së, ka njoftuar se heqë dorë nga licenca e operatorit të shpërndarjes, sipas platformës OTT.

Arsyetimi


4. Përmes kërkesës operatori i shpërndarjes IPTV SHQIP ka deklaruar se arsye për heqje dorë nga licenca e KPM-së janë problemet financiare.

5. Nga evidencat në Zyrën Ekzekutive të KPM-së rezulton se IPTV SHQIP nuk ka obligime financiare ndaj KPM-së.
6. Duke u bazuar në njoftimin e pronarit të operatorit të shpërndarjes IPTV SHQIP, për heqje dorë nga licenca në mënyrë vullnetare, Komisioni vlerëson se ka bazë të mjaftueshme për ndërprerjen dhe shpalljen e pavlefshme të licencës së operatorit të shpërndarjes IPTV SHQIP.

Vendim

7. Komisioni në takimin e tij të mbajtur më datën 21 dhjetor 2021, merr vendim për ndërprerjen dhe shpalljen e pavlefshme të licencës së Operatorit të Shpërndarjes IPTV SHQIP, me seli në Pejë, sipas njoftimit për heqje dorë në mënyrë vullnetare nga Licenca e KPM-së.

8. Këtë vendim e lëshon Komisioni, dhe i njëjti hyn në fuqi nga data e nënshkrimit.



Xhevat LATIFI

Kryetar

Komisioni i Pavarur i Mediave



21. 12. 2021

datë